



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA FUSHË-ARRËZ
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE**

Nr 1546 prot.

Fushë-Arrëz, më 13.05.2026

MIRATOHET
KRYETARI

HIL. CURRI



PLAN – MASASH

**PËR PËRBALLIMIN E SITUATAVE EMERGJENTE QË MUND TË
KRIJOHEN NGA RESHJET E SHIUT, DËBORËS, PËRMBYTJET,
NGRICAT DHE ZJARRET NË PYJE GJATË VITIT 2026**

I. BAZA LIGJORE

Ky Plan Masash hartohet në mbështetje të:

Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKM nr. 965, datë 02.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstitutional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave”, Strategjisë Kombëtare për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë, Planeve të Emergjencave Civile në nivel qendror dhe vendor, Akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e mbrojtjes civile.

II. OBJEKTIVI

Mobilizimi, koordinimi dhe angazhimi i të gjitha kapaciteteve njerëzore, teknike dhe logjistike të institucioneve publike, strukturave private dhe komunitetit në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz për parandalimin, përballimin dhe menaxhimin eficient të emergjencave civile që mund të krijohen nga reshjet intensive të shiut, dëborës, përmbytjet, ngricat dhe zjarret në pyje e kullota.

III. QËLLIMI

Qëllimi i këtij plani është:

- Marrja e masave parandaluese dhe operacionale;
- Rritja e nivelit të gatishmërisë së strukturave përgjegjëse;
- Garantimi i koordinimit ndërinstitutional;
- Mbrojtja e jetës së qytetarëve, pronës publike e private, bagëtive dhe mjedisit;
- Sigurimi i vazhdimësisë së shërbimeve bazë ndaj komunitetit;
- Reduktimi i pasojave ekonomike dhe sociale nga fatkeqësitë natyrore.

IV. DREJTIMI DHE KOORDINIMI

Për drejtimin dhe koordinimin e masave për përballimin e situatave emergjente ngarkohen:

- Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz;
- Komisioni Vendor i Mbrojtjes Civile (KVMC);
- Sektori i Mbrojtjes Civile;
- Administratorët e Njësive Administrative;
- MZSH;
- Drejtoritë dhe sektorët e Bashkisë;
- Institucionet shtetërore që ushtrojnë aktivitet në territor;
- Strukturat e Policisë së Shtetit;
- Strukturat e Forcave të Armatosura;
- Strukturat shëndetësore;
- Operatorët e energjisë elektrike dhe ujësjellës-kanalizimeve;
- Bizneset private dhe grupet vullnetare.

V. MASAT E BASHKISË, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E SAJ

1. Të aktivizohen dhe përditësohen planet e emergjencave civile, planet e gatishmërisë, planet e bashkëpunimit dhe skemat e njoftimit e alarmimit për të gjitha strukturat në nivel bashkie dhe njësish administrative.
2. Të organizohet monitorimi i pandërprerë i situatës në terren nga:
 - administratorët e njësive administrative;
 - strukturat e mbrojtjes civile;
 - MZSH;
 - drejtuesit e institucioneve.
3. Të evidentohen zonat me risk nga:

- përmbytjet;
 - rrëshqitjet e dherave;
 - izolimi nga dëbora;
 - ngricat;
 - zjarret në pyje dhe kullota.
4. Të kërkohet nga institucionet përgjegjëse vlerësimi i riskut dhe nevojat emergjente për ndërhyrje.
 5. Të mbahet komunikim i vazhdueshëm me Prefekturën e Qarkut Shkodër, AKMC dhe institucionet qendrore për mbështetje me mjete dhe logjistikë.
 6. Të bashkëpunohet me Autoritetin Rrugor Verior për:
 - mirëmbajtjen e akseve rrugore;
 - monitorimin e kontratave të mirëmbajtjes;
 - ndërhyrjen në kohë për pastrimin e rrugëve.
 7. Të hartohet grafiku i shërbimit 24 orë për:
 - Bashkinë;
 - Njësitë Administrative;
 - strukturat operacionale.
 8. Të sigurohen rezervat materiale:
 - kripë;
 - granil;
 - skorje;
 - karburant;
 - materiale ndihmëse.
 9. Të evidentohen dhe vihen në dispozicion:
 - fadromat;
 - mjetet borëpastruese;
 - automjetet e transportit;
 - mjetet e kalueshmërisë së lartë.
 10. Të evidentohen objektet që do të përdoren për strehim emergjent:
 - shkolla;
 - palestra;
 - qendra komunitare;
 - godina publike.

VI. BASHKËPUNIMI ME STRUKTURAT E POLICISË SË SHTETIT

1. Të përditësohen planet operacionale të bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Bashkisë.
2. Të bashkëpunohet për:
 - disiplinimin e qarkullimit rrugor;

- menaxhimin e trafikut;
- bllokimin e akseve të rrezikshme.
- 3. Të organizohen patrullime të vazhdueshme në zonat me risk.
- 4. Të evidentohen dhe të mbahen në gatishmëri:
 - forcat operacionale;
 - automjetet;
 - pajisjet e komunikimit.
- 5. Të bashkëpunohet me FNSH për:
 - operacionet e shpëtimit;
 - evakuimin e banorëve;
 - ndërhyrjet në zonat e izoluara.
- 6. Të sigurohet shkëmbimi në kohë reale i informacionit me Sallën Operative të Bashkisë.

VII. BASHKËPUNIMI ME FORCAT E ARMATOSURA

1. Të mbahen komunikime të vazhdueshme me strukturat ushtarake.
2. Të bashkëpunohet për:
 - evakuimin e popullsisë;
 - transportin e emergjencave;
 - shpërndarjen e ndihmave.
3. Të organizohet ngritja e kampeve të përkohshme me çadra në rast emergjence.
4. Të vihen në dispozicion mjetet logjistike sipas kërkesave të Prefektit dhe Bashkisë.
5. Të bashkëpunohet për hapjen e akseve rrugore të bllokuara.

VIII. MASAT PËR STRUKTURAT SHËNDETËSORE

1. Të përditësohen planet shëndetësore të emergjencës.
2. Të sigurohet shërbim mjekësor në të gjitha njësitë administrative.
3. Të sigurohen rezerva me:
 - medikamente;
 - materiale mjekësore;
 - medikamente antigripale.
4. Të mbahet në gatishmëri personeli mjekësor dhe infermieror.
5. Të organizohet transporti i emergjencave shëndetësore.
6. Të bashkëpunohet me:
 - Policinë;
 - FNSH;

- Bashkinë;
 - Prefekturën.
7. Të garantohen ndërhyrjet për emergjencat shëndetësore edhe në zonat e izoluara.

IX. BASHKËPUNIMI ME AUTORITETIN RRUGOR VERIOR

1. Të monitorohen kontratat e mirëmbajtjes së akseve rrugore.
2. Të sigurohet gatishmëria teknike e kompanive kontraktore.
3. Të magazinohen materiale për trajtimin e ngricave.
4. Të evidentohen akset më problematike në territorin e bashkisë.
5. Të bashkëpunohet me Policinë Rrugore për:
 - menaxhimin e qarkullimit;
 - ndërhyrjet emergjente;
 - sigurimin e kalueshmërisë.

X. MASAT PËR INSTITUCIONET ARSIMORE

1. Të monitorohet situata në të gjitha institucionet arsimore.
2. Të sigurohen kushtet e ngrohjes në shkolla dhe kopshte.
3. Të evidentohen objektet që mund të përdoren për strehim emergjent.
4. Në raste emergjente të propozohet pezullimi i procesit mësimor.
5. Të bashkëpunohet me Bashkinë për garantimin e sigurisë së nxënësve.

XI. MASAT DHE BASHKËPUNIMI ME NËNPREFEKTIN DHE INSTITUCIONIN E PREFEKTIT

1. Të bashkëpunohet ngushtësisht me Institucionin e Prefektit për monitorimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin e situatave emergjente në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz.
2. Të informohet periodikisht Prefekti i Qarkut mbi:
 - zhvillimin e situatës emergjente;
 - masat e marra nga Bashkia;
 - funksionimin e strukturave operacionale;
 - nivelin e gatishmërisë së institucioneve vendore.
3. Të organizohet bashkëpunimi për zhvillimin e mbledhjeve të Shtabit Vendor të Emergjencave Civile dhe koordinimin ndërinstitutional për përballimin e situatave emergjente.
4. Të bashkëpunohet me institucionet e shëndetësisë dhe arsimit për:
 - sigurimin e rezervave me medikamente mjekësore;
 - garantimin e shërbimit shëndetësor në zonat e prekura;
 - sigurimin e lëndës djegëse për ngrohjen në institucionet arsimore.

5. Të sigurohet shkëmbimi i vazhdueshëm i informacionit ndërmjet Bashkisë, Prefekturës dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për të garantuar reagim të koordinuar dhe në kohë reale ndaj çdo situatë emergjente.
6. Të bashkëpunohet me strukturat e Prefekturës për evidentimin e dëmeve dhe përgatitjen e dokumentacionit për përfitimin e ndihmës financiare sipas legjislacionit në fuqi.

XII. MASAT PËR OSHEE, OST DHE UJËSJELLËS-KANALIZIME

1. Të sigurohet gatishmëria e grupeve të avarisë.
2. Të evidentohen defektet dhe të ndërhyhet menjëherë për riparimin e tyre.
3. Të sigurohet furnizimi me energji elektrike për:
 - o institucionet prioritare;
 - o qendrat shëndetësore;
 - o objektet emergjente.
4. Të monitorohet rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm.
5. Të merren masa për mbrojtjen e sistemeve hidraulike nga ngricat.

XIII. MASAT PËR MBROJTJEN NGA ZJARRET NË PYJE DHE KULLOTA

1. Të hartohen hartat e zonave me risk të lartë nga zjarret.
2. Të organizohen patrullime monitoruese gjatë sezonit veror.
3. Të bashkëpunohet me:
 - o PMNZSH;
 - o Pyjoret;
 - o Njësitë Administrative;
 - o komunitetin.
4. Të ndalohet ndezja e zjarreve në pyje dhe kullota sipas legjislacionit në fuqi.
5. Të organizohen fushata ndërgjegjësimi për komunitetin.
6. Të evidentohen burimet ujore për furnizimin e automjeteve zjarrfikëse.
7. Të mbahet në gatishmëri personeli dhe pajisjet zjarrfikëse.

XIV. MASAT PËR AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT

1. Të monitorohet siguria ushqimore në të gjithë territorin.
2. Të kontrollohen subjektet tregtare dhe magazinat ushqimore.
3. Të sigurohen rezervat ushqimore për zonat që mund të izoloohen.
4. Të monitorohen kushtet higjeno-sanitare në rast emergjence.

XV. MASAT PËR DREJTORINË E BUJQËSISË

1. Të evidentohen nevojat për bazë ushqimore për bagëtitë.
2. Të bashkëpunohet me bizneset private për sigurimin e rezervave.
3. Të mbahen statistika për zonat më problematike.
4. Të raportohen dëmet në sektorin bujqësor dhe blegtoral.

XVI. MASAT NË FAZËN PARANDALUESE

1. Të hartohen dhe përditësohen planet e emergjencës.
2. Të evidentohen familjet në risk.
3. Të përcaktohen vendet e evakuimit.
4. Të organizohen stërvitje dhe simulime.
5. Të planifikohet fondi rezervë për emergjencat civile.
6. Të organizohet sistemi i njoftimit dhe alarmimit.
7. Të evidentohen grupet vullnetare.
8. Të verifikohen sistemet e kullimit dhe ujësjellësit.
9. Të evidentohen mjetet private që mund të angazhohen në emergjencë.
10. Të organizohet monitorimi i vazhdueshëm meteorologjik.

XVII. MASAT NË FAZËN E EMERGJENCËS

1. Të mbledhet menjëherë Komisioni Vendor i Mbrojtjes Civile.
2. Të aktivizohet Salla Operative e Emergjencave.
3. Të organizohen grupet e punës për:
 - o vlerësimin e dëmeve;
 - o evakuimin;
 - o ndihmën humanitare.
4. Të evidentohen:
 - o familjet e prekura;
 - o dëmet infrastrukturore;
 - o nevojat emergjente.
5. Të organizohet furnizimi me:
 - o ushqime;
 - o ujë të pijshëm;
 - o medikamente;
 - o energji elektrike.
6. Të organizohen operacionet e evakuimit dhe shpëtimit.
7. Të mbahet komunikim i pandërprerë me Prefekturën dhe AKMC.
8. Të sigurohet bashkëpunimi me:
 - o Ushtrinë;
 - o Policinë;

- PMNZSH;
 - kompanitë private.
9. Të përgatiten raportet dhe statistikat për dëmet.
 10. Të organizohen operacionet për pastrimin e rrugëve dhe rikthimin e normalitetit.

XVIII. MENAXHIMI I INFORMACIONIT

1. Informacioni për situatën emergjente të administrohet nga Salla Operative.
2. Raportimi të bëhet periodikisht sipas nivelit të emergjencës.
3. Informacioni zyrtar për publikun të shpërndahet vetëm nga autoritetet kompetente.
4. Të mbahet dokumentacion i plotë për:
 - dëmet;
 - ndërhyrjet;
 - fondet;
 - ndihmat.

XIX. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Të gjitha institucionet janë të detyruara të zbatojnë detyrat e përcaktuara në këtë plan.
2. Moszbatimi i detyrave ngarkon përgjegjësi administrative dhe ligjore sipas legjislacionit në fuqi.
3. Ky Plan Masash hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Kryetari i Bashkisë.

PERGJEGJESI I SEKTORIT

TË MBROJTJES CIVILE BASHKIA FUSHË-ARRËZ

ING. DOD PEPA

